



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sporteve, rr. Ramiz Sadiku Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com

Numri i protokollit: 2026-_____

Data: 03/08/2026

Emri i projektit: "Digjitalizimi i FPPK-së"

Për: Kompani ose individë të specializuar për digjitalizim

Afati i fundit: 30 gusht 2026, ora 16:00

I. FTESA PËR OFERTË

Federata e Pingpongut e Kosovës (FPPK) fton të gjithë individët dhe kompanitë e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre financiare dhe teknike për krijimin e një sistemi digjital të integruar në një uebsajt dinamik dhe aplikacion celular. Sistemi duhet të mbështesë dhe automatizojë plotësisht proceset e federatës në përputhje me Statutin dhe Rregulloret zyrtare të FPPK-së dhe ITTF-së.

Modulet kryesore që duhet të përfshihen:

- 1. Uebsajti zyrtar dhe Paneli Admin:** CMS dinamik, dy gjuhë (AL/EN) me mundësi menaxhimi të lajmeve, dokumenteve publike, strukturës organizative dhe njoftimeve.
- 2. Sistemi i Roleve dhe Sigurisë:** Qasje e kontrolluar me role (Admin, Gjyqtar, Sportist, Klub, Trajner) dhe ruajtje e plotë e historikut të veprimeve (Audit Trail).
- 3. Kalendari Dinamik i Garave:** Modul qendror dhe vizual për caktimin e turneve, menaxhimin e afateve dhe kalendarin publik dinamik.
- 4. Regjistrimi i Klubeve & Anëtarëve:** Modul online për licencimin vjetor të klubeve, rosterëve të lojtarëve, trajnerëve, afateve kalimtare (transfereve) dhe verifikimit të lojtarëve të huaj.
- 5. Moduli i Garave & Ligave:** Shorti automatik dhe manual, Superliga, Liga e Parë/Dytë, Kupa e Kosovës dhe procesverbalet.
- 6. Menaxhim i Turneve Specifikë:** Matrica dhe orare të mbyllura specifike për turnetë e tipit 'Top 8 / Top 12' dhe Turnetë e Ftuar.
- 7. Moduli i Gjyqtarëve (Delegimet):** Licencat e gjyqtarëve (Blue Badge, etj.), slotet e lira, aplikimet e refereve dhe menaxhimi qendror i delegimeve.
- 8. App Celular & Live Scoring:** Aplikacion celular (Android & iOS) për publikun dhe interfejs special i shënimit të pikëve live (point-by-point) me mundësi pune Offline për gjyqtarët.
- 9. Algoritmi i Ranglistës:** Kalkulim automatik në kohë reale i të 13 ranglistave zyrtare të FPPK-së, duke integruar bonuset progresive, penalizimet për mungesë dhe pikët mbrojtëse.
- 10. Migrimi i të Dhënave:** Importimi, pastrimi dhe strukturimi i historikut ekzistues të lojtarëve, klubeve dhe ranglistave të vjetra në sistemin e ri.

II. KRITERET E PJESËMARRJES

- Eksperiençë e dëshmuar në zhvillimin e sistemeve digjitale dhe aplikacioneve celulare.
- Portofol i projekteve të ngjashme ose përvojë në zhvillimin e platformave sportive.
- Kapacitet i plotë për mirëmbajtje afatgjatë dhe mbështetje teknike.
- Ofertë financiare e qartë, e ndarë dhe e arsyetuar sipas moduleve.

III. KUSHTET TEKNIKE DHE JURIDIKE

- 1. Pronësia e Sistemit:** Pas pagesës përfundimtare, FPPK do të jetë pronare e plotë e të gjitha të drejtave të softuerit dhe e kodit burimor (Source Code).
- 2. Garantimi dhe Mirëmbajtja:** Ofertuesi duhet të ofrojë një periudhë garancie prej të paktën 6 muajsh pa pagesë shtesë për eliminimin e gabimeve (bugs). Pas garancisë, ofrohet mbështetje sipas kontratës mujore (ndërrhyrje brenda 24 orëve).
- 3. Trajnimi dhe Manuali:** Ofertuesi obligohet të organizojë sesione trajnimi praktike për stafin, klubet dhe gjyqtarët, si dhe të dorëzojë manualet e plota në format digjital.
- 4. Mbrojtja e të Dhënave:** Sistemi duhet të ndërtohet në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale në Kosovë (GDPR vendor).
- 5. Përputhshmëria Rregullative:** Sistemi duhet të zbatojë me saktësi absolute automatizimet matematike dhe rregullat operative të përcaktuara në Rregulloret e Garave dhe Ranglistës së FPPK-së.

IV. VLERËSIMI I OFERTAVE

Vlerësimi do të bëhet nga Komisioni i FPPK-së, ku kontrata do t'i jepet ofertuesit që grumbullon pikët më të larta sipas peshimit të mëposhtëm:

- Cilësia e ofertës teknike (Zgjidhja e propozuar): 50%
- Eksperienca dhe referencat e ngjashme: 15%
- Çmimi i propozuar (Oferta financiare): 25%
- Afatet e realizimit dhe fleksibiliteti: 10%

V. UDHËZIMET PËR DORËZIM

- Afati i fundit i dorëzimit është data 30.08.2026, ora 16:00.
- Dorëzimi bëhet ekskluzivisht me e-mail në adresën zyrtare: info@fppk.com
- Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në valutën Euro (€), me TVSH të përfshirë.
- Oferta duhet të jetë e vlefshme për të paktën 30 ditë nga afati i dorëzimit.

VI. TABELA E OFERTËS FINANCIARE

Ofertuesi duhet të plotësojë çmimet për secilin modul/shërbim të kërkuar:

Nr.	Moduli / Shërbimi	Specifikimi i Përmbledhur	Çmimi (€)
1	Uebfaqja dhe Paneli Admin	CMS dinamik, dy gjuhë (AL/EN), lajmet, dokumentet publike.	
2	Sistemi i Roleve dhe Sigurisë	Menaxhimi i llogarive, autorizimet e veçanta, Audit Trail.	
3	Kalendari Dinamik i Garave	Modul qendror për caktimin e turneve dhe automatizimin e afateve.	
4	Regjistrimi i Klubeve & Anëtarëve	Licencimi online, rosterët e lojtarëve, transferet, lojtarët e huaj.	
5	Moduli i Garave & Ligave	Shorti ITTF (ndarja e klubeve), Superliga, Liga 1/2, Kupa e Kosovës.	
6	Menaxhim i Turneve Specifikë	Matrica të mbyllura për Top 8 / Top 12 dhe Turnetë e Ftuar.	
7	Moduli i Gjyqtarëve (Delegimet)	Licencat (Blue Badge, etj.), slotet e lira dhe menaxhimi i delegimeve.	
8	App Celular & Live Scoring	Pjesa publike dhe ndërfaqja offline për gjyqtarët (point-by-point).	
9	Algoritmi i Ranglistës	Automatizimi i 13 ranglistave dhe formulave të pikëve (bonuset/gjobat).	
10	Migrimi i të Dhënave	Importimi i historikut, klubeve dhe ranglistave ekzistuese në sistem.	
11	Mirëmbajtja Mujore	Kostoja mujore e mbështetjes teknike (për 12 muaj).	
TOTALI		(Me TVSH të përfshirë)	

Emri i Kompanisë / Ekspertit: _____

Përfaqësuesi / Nënshkrimi: _____

Data: ____/____/2026

Vula (nëse aplikohet): _____